

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me zyrtar ligjor Durim Balaj, në çështjen penale kundër të pandehurit V.A. nga P., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5648/18, të datës 25.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 29.10.2018, në prezencën e Prokurores së Shtetit Nebahate Salihu, të akuzuarit, Av.F.U.I., të njëjtën ditë mori publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V.A. i biri H., dhe e ëma L., e gjinisë R. i lindur më ..., në P., tani me vendbanim në rr. "A.R." me nr.personal ..., i pamartuar, i gjendjes së ulet ekonomike, i papune, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet ne ndalim nga dt.30.09.2018 ne ora 13:00.

ËSHTË FAJTOR

Sepse;

Me dt: 27.09 2018 rreth orës 08:50, në rr. A.R.- P., deri sa e dëmtuara M.R. ka qenë duke ecur në të njëjtën rrugë ajo është sulmuar nga i pandehuri i cili fillimisht ka bërëtitur diçka e më pas ka përdorur forcë ndaj saj duke e goditur me shuplak në fytyrë në anën majtë,-

-Me këtë në varësi nga Droga ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 46, 49, 51,52, 58, 59 73 të KPRK-së si dhe nenit 365, 503 të KPPRK-së, të njëjtë i shqipton;

Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues

Ashtu që të akuzuarin V.A.e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari i nënshtrohet edhe vullnetarisht mjekimit ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor dhe heq dorë nga përdorimi i drogës.

Koha e kaluar në paraburgim nga dt:30.09.2018 e deri me 30.10.2018, i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Obligohet: i akuzuari që të mbaj kontakt të rregullt me Organin e shërbimit sprovues, e nëse personi i dënuar nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e përmbush detyrimin e paraparë nga gjykata, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes në kuadër të kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht.

Obligohet: i akuzuari që të në emër të paushallit gjyqësor, gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

E dëmtuara: M.R., me vendbanim në rrugën "H.Z.", nr...., në P., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Në bazë të nenit 91par1 pika 1.1 dhe 1.2 të njëjtit i caktohet;

Trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm i personave të varur nga droga ose alkooli

Trajtimi i të pandehurit do të bëhet në mënyrë Hospitalore në Qendrën Klinike universitare në Prishtinë- Klinika e Psikiatrisë- reparti i sëmundjeve të varësisë.

Obligohet; Klinika e Psikiatrisë- reparti i sëmundjeve të varësisë, ta njoftoj gjykatën me raport të veçante çdo dy muaj lidhur me procesin e rehabilitimit të të pandehurit.

Të pandehurit i ndërprehet masa e paraburgimit me dt:30.10.2018 dhe Urdhërohet transferimi i të pandehurit nga instituti i psikiatrisë Forenzike në Klinikën e Psikiatrisë- reparti i sëmundjeve të varësisë, nga data 30.10.2018.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën, PP.II.nr.5648/18, të datës 25.10.2018 kundër të pandehurit V.A. nga P., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestarë dhe pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar, pas konsultimeve me mbrojtësen e tijë me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë së shtetit, PP.II.nr.5648/18, të datës 25.10.2018.

Pas deklarimit të të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Prokurori i Shtetit Nebahate Salihu, dha mendimin e saj lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi që i pandehuri me vullnetin e tij të lire dhe pas konsultimit edhe me mbrojtësin tij duke qenë në dijeni për rolin dhe rëndësinë e pranimin të fajësisë në këtë fazë ku i njëjti pranon akuzën në të gjitha pikat të cilat i vihen në barrë për veprën e penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së. Në rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin nga ana e gjykatës të vlerësohet pranimi i fajësisë.

Av.F.U.I., caktuar sipas detyrës zyrtare deklaroj se duke u bazuar në ndërgjegjen e të mbrojturit tim i cili në mënyrë bindëse e pranon fajësinë apo veprimet e tija në ditën kritike, andaj propozoj

prokurorisë dhe gjykatës që këtë institucion ta pranojë në atë mënyrë duke arsyetuar edhe moskundërshtimin e propozimit të prokurorisë me arsye se i njëjti që me konsultimet e para në mbrojtjen , i njëjti thotë se : Masa deri me tani gjatë vuajtjes së masës së paraburgimit ka ndikuar pozitivisht në mirëqenien e tij psikike duke u penduar dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën apo veprimet e tilla, andaj nuk e kundërshtojmë edhe masën e propozuar nga prokuroria.

I akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë deklaroj se: pajtohet me thëniet e avokatit të tij, ndërsa shton se më vjen shumë keq për të dëmtuarën dhe njëkohësisht edhe për gjykatën.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestar u vërtetua se ai me datë kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si deklarata e të dëmtuarës M.R. me dt 27.09.2018, si dhe dokumentacionet dhe shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së., për të cilën akuzohet i pandehuri. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e shqiptimit të dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata gjeti faktin se i njëjti bazuar në ekspertizën mjeko-ligjore të grupit të ekspertëve :Dr. G.H., Dr.J.Z. dhe Sh.H. , si dhe deklarimeve të ekspertit Dr.J.Z. në shqyrtimin gjyqësorë i akuzuari veprën penale e ka kryer pasi që i njëjti ka varësi nga droga dhe se ka nevojë të trajtohet në qendër të specializuar që merret me trajtimin e sëmundjeve të varësisë nga substancat Psikoaktive, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73 par.2, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 91par1 pika 1.1 dhe 1.2 lidhur me masën Trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm i personave të varur nga droga ose alkooli, vendosi pas shikimit dhe vlerësimit të ekspertizës mjeko-ligjore të grupit të ekspertëve :Dr. G.H., Dr. J.Z. dhe Sh.H. si dhe dëgjimit të ekspertit Dr. J.Z. i cili në shqyrtimin gjyqësor të dt:29.10.2018 ka deklaruar; Mbeten në tërësi në vlerësimin psikiatrik të të pandehurit V.A.te kryer me dt 25.10.2018 , pas kërkesës së gjykatës që të pandehurit ti kryhet një vlerësim psikiatrik është bere caktimi i eksperteve te cilët do ta kryejnë këtë vlerësim, ky vlerësim është kryer në mënyrë hospitalore në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë, intervistimi i të pandehurit në mënyrë individuale dhe ekipore , shqyrtimi i shkresave të lëndës, ekzaminimet si CT-ja , EEG-ja dhe analizat laboratorike, raporti i punëtorit social, konsultimi i literaturës dhe analiza e rasteve të ngjashme.

Ka shtuar se Intervistimi nuk ka qene i përcjellë me ndonjë vështirësi, i ekzaminuari kryesisht ka qene bashkëpunues me ekipin vlerësues , po ashtu te i njëjti nuk është shfaqur ndonjë stomatologji

e kualitetit psikotip , po ashtu te i njëjti nuk janë gjetur ngecje ne zhvillim te inteligjencës, dhe ka treguar inteligjencë mesatare ne raport me edukimin, po ashtu është përjashtuar çrregullimi organik cerebral, gjate qëndrimit ne institut ka shfaqur kriza te abstinencës, tërheqjes nga përdorimi i marihuanes me te cilat janë trajtuar me antidepresive dhe anksiolitike sipas nevojës, te i ekzaminuari është përjashtuar c rregullimi psikotik, po ashtu është konstatuar se nuk ka prapambetje mendore, ndërsa për sa i përket ditës kritike te kryerjes se veprës për te cilën akuzohet apo ngarkohet, aftësia e te kuptuarit dhe kontrolles se veprimeve te veta ka qene e zvogëluar por jo esencialisht, te i njëjti është ardhë ne përfundim se vuan na çrregullimi mendor si pasoje e përdorimit te kanabioideve(mariuanes) dhe çrregullim i personalitetit e qe ne klasifikimin ndërkombëtar kodohet me F12, dhe F60. Bazuar ne te dhënat qe kemi ne dispozicion, këta persona kane nevojë për trajtim medikamentoz , simptomatik dhe rehabilitim biopsikosocial me qellim te përforcimit motivacional ne drejtim te ndërprerjes se abuzimit me substanca me qellim qe te ruhet gjendja e abstinencës e qe mund te merret ne ndonjë qofte edhe ne Klinikën e Psikiatrisë qe është reparti i sëmundjeve te varësisë ose ne ndonjë qendër tjetër qe është e specializuar për sëmundje te varësisë. Bazuar edhe ne te dhënat nga ana e te te ekzaminuarit dhe familjareve te tij, veçanërisht nenës , i njëjti ka histori te trajtimit psikiatrik nga viti 2013 mirëpo nuk ka qene i rregullt ne kontrole dhe ne përdorimin e terapisë, duke shtuar se Këto raste mund te trajtohen edhe ne mënyrë ambulatorore dhe hospitalore, mirëpo ne rastin konkret mendojmë qe ka nevojë qe te motivohet ne aspektin psikik për ndërprerjen e përdorimit te substancave te tipit marihuane , për momentin konsiderojmë se trajtimi hospitalor është i nevojshëm.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Gjykata konform nenint 463 paragrafi 3 të KPRK-së, palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoj në kontest të rregullt juridiko-civil.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365, 366 503 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
 Departamenti i përgjithshëm-Penal
 P.nr.4503/18 të dt: 29.10.2018

Zyrtar Ligjor,
 Durim Balaj

Gjyqtari,
 Kujtim Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë(15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.